



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
K R Y E T A R I

Nr. 818/7 Prot.

Tiranë, më 31/12/2016

V E N D I M
Nr. 180, Datë 31.12.2016

PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË
DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË SHËRBIMEVE DHE
TRANSPORTIT RRUGOR TIRANË, MBI “ZBATIMIN E
LIGJSHMËRISË, RREGULLSHMËRISË SË VEPRIMTARISË
EKONOMIKO - FINANCIARE”

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

- I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë për periudhën e auditimit nga 01.01.2013 deri në 30.06.2016.
- II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së dërguar me shkresën nr. 167/8 prot., datë 30.06.2012, u konstatua:

KLSH ka rekomanduar **2 propozime për ndryshime dhe përmirësime në legjislacionin** në fuqi, të cilat nuk janë realizuar.

Nga **12 masa organizative** të rekomanduara, 8 janë realizuar dhe 4, nuk janë realizuar.

Nga **5 masa për shpërblim dëmi ekonomik** në vlerën 17,933,713 lekë, nuk është realizuar asnjë.

Nga **10 masa disiplinore** për 10 persona me “*Vërejtje me shkrim*” janë zbatuar të gjitha (*trajtuar më hollësisht në faqet 15 deri 19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

1.1 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, të marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të kërkuara me shkresën nr. 167/8 prot., datë 30.06.2012, në zbatim të kërkesave ligjore.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi:

-Të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2013, janë në masën 1,533,833 mijë lekë nga 1,666,600 mijë lekë të planifikuara, pra realizimi është në masën 92% ose 132,767 mijë lekë më pak. Pjesa më e madhe e këtij mosrealizimi ka ardhur për shkak të ndryshimeve në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”.

-Shpenzimet e realizuara gjatë vitit 2013, janë në shumën 1,248,774 mijë lekë, nga 1,486,600 mijë lekë të parashikuara në Programin Ekonomik të vitit 2013. Janë realizuar rreth 237,826 mijë lekë më pak ose në nivelin 84%. Pra, rezulton me mosrealizim të shpenzimeve në fakt, krahasuar me nivelin e programimit, për këtë vit (*trajtuar më hollësisht në faqet 19 deri 30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

2.1 Drejtoria Ekonomike të marrë masa për programimin e saktë dhe të argumentuar të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuara për zhvillimin e aktivitetit dhe veprimtarisë së institucionit.

Në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi:

Të gjitha shpërblimet, e marra për periudhën 2013-2016, për vështirësi për mbledhjen e taksës së mjeteve të përdorura, nuk kanë marrë një miratim nga Ministri i Transporteve dhe Infrastrukturës, kërkesë e nenit 6 pika 1 gërma b e Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për Pagat dhe Shpërblimet”(trajtuar më hollësisht në faqet 30 deri 37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

3.1 DPSHTRR të marrë masa që të gjitha shpërblimet e punonjësve, për vështirësi për taksën e mjeteve të përdorura, etj, të miratohen nga Ministri i Transporteve dhe Infrastrukturës, bazuar në Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për Pagat dhe Shpërblimet”.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4. Gjetje nga auditimi:

Këshilli Drejtues i DPSHTRR, ka vendosur një shpërblim prej 2.4 paga mujore (pagës si Anëtarë të Këshillit Drejtues), të marrin dhe anëtarët e këtij Këshilli, duke vendosur të shpërblej veten, në kundërshtim me pikën 5 të VKM-së nr. 317, datë 07.08.1999, ku thuhet: “Këshilli Drejtues mund të marri shpërblim deri në dy paga në vit. Shpërblimi për

Këshillin Drejtues caktohet nga organi që ka në kompetencë emërimin” (trajtuar më hollësisht në faqet 30 deri 37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

4.1 *Këshilli Drejtues për shpërblimet e anëtarëve të tij, duhet të marrë paraprakisht miratim nga Ministri i Transporteve dhe Infrastrukturës, i cili ka kompetencën e vendimmarrjes, në bazë të VKM-së nr. 317, datë 07.08.1999.*

Menjëherë dhe në vazhdimësi

5. Gjetje nga auditimi:

Në mbledhjet e zhvilluara nga Këshilli Drejtues, nuk rezulton të jenë trajtuar problemet e plotësimit të detyrave dhe kompetencave të Drejtorisë së Kontrollit dhe Sigurisë Rrugore, të cilat janë përcaktuar në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për Transportin Rrugor” i ndryshuar, në udhëzimin nr. 1649, datë 16.08.1999 të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta të transportit rrugor të udhëtarëve” i ndryshuar si dhe nenit 9 të udhëzimit nr. 4162, datë 18.10.1999 “Mbi kontrollin shtetëror dhe mbikëqyrjen e kualifikuar në transportin rrugor” i ndryshuar i MPPTsë.

Në këto akte ligjore janë përcaktuar detyrat që kryen Drejtoria e Kontrollit dhe Sigurisë Rrugore, strukturë e posaçme në përbërje të DPSHTRR, e cila duhet të ushtrojë kontroll të vazhdueshëm shtetëror dhe të kualifikuar, në subjektet e transportit rrugor dhe në agjencitë e udhëtarëve.

Në veçanti, kontroll i vazhdueshëm ushtrohet për zbatimin e çmimit të biletave, të subjekteve të transportit rrugor të udhëtarëve dhe për paisjen me bileta të udhëtarëve që udhëtojnë në linjat e rregullta të transportit qytetas, në transportin rreth qytetas, në linjat ndërmjet qyteteve, në transportin ndërkombëtar dhe në transportin taksi etj. Nisur nga problematika që zhvillon Drejtoria e Kontrollit dhe Sigurisë Rrugore dhe nga gjendja aktuale ku ndodhet shërbimi transportit rrugor të udhëtarëve:

Për këtë rekomandojmë:

5.1 *Auditi i Brendshëm të auditojë çdo vit veprimtarinë, detyrat dhe zbatimin e kompetencave të Drejtorisë së Kontrollit dhe Sigurisë në rrugë.*

5.2 *Këshilli Drejtues i DPSHTRR, çdo vit të analizojë raportin e Auditit të Brendshëm, në mbledhje të veçantë plotësimin e detyrave nga Drejtoria e Kontrollit dhe Sigurisë Rrugore.*

Në vazhdimësi

6. Gjetje nga auditimi:

Nga ana e Drejtorisë Ekonomike janë ushtruar kontrole të herëpashershme lidhur me raportimet e Drejtorive Rajonale në DPSHTRR, duke krahasuar të dhënat nga sistemi informatik, me të dhënat e raportuara prej tyre në evidencat dhe raportimet mujore për Administratën Tatimore, por kjo e kufizuar vetëm për pjesën e aktivitetit që është e informatizuar. *(trajtuar më hollësisht në faqet 37 deri 44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për këtë rekomandojmë:

6.1 *Nga Drejtoria Ekonomike të ushtrohen kontrole (bazuar në detyrat e saj) në Drejtoritë Rajonale lidhur me zbatimin e rregullores së financës së Drejtorive Rajonale.*

Në vazhdimësi

7. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se nuk janë kryer trajnime dhe kualifikime për punonjësit e financës në bazë të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. *(trajtuar më hollësisht në faqet 37 deri 44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për këtë rekomandojmë:

7.1 Të zhvillohen trajnime dhe kualifikime për zhvillimin e kapaciteteve profesionale të punonjësve të financës, në bazë të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Në vazhdimësi

8. Gjetje nga auditimi:

Në gjashtë raste në vlerën 1,250,036 lekë pa TVSH, për të njëjtën grup artikujsh apo natyrë të njëjtë malli, shërbim apo pune, janë realizuar prokurime me vlera të vogël duke shmangur procedurat e tenderimit sepse është tejkualuar vlera prej 400,000 lek. Veprim në kundërshtim me kreun II, pika 1, gërma c, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007, ‘‘Për rregullat e Prokurimit Publik’’ i ndryshuar me kreun II, neni 8, pika 4, të VKM nr. 914 datë 29.12.2014, ‘‘Asnjë kontratë publike nuk mund të ndahet për shmangien e kufirit monetar apo të procedurave, të parashikuara nga LPP-ja’’.

-Në dy raste në vlerën 531,658 lekë pa TVSH, janë realizuar praktika të blerjeve me vlera të vogla për raste emergjente, nëpërmjet procedurave prokurimi manuale (me procedure/shkresore) duke eliminuar procedurat nëpërmjet platformës elektronike të APP, në kundërshtim me VKM nr. 1 datë 10.01.2007, Kreu VI, pika 2, gërma ç, ‘‘Prokurime me vlera të vogla’’i ndryshuar me VKM nr. 914. Datë 29.12.2014, neni 40, ‘‘Prokurime me vlera të vogla’’.

-Në procedurën elektronike për blerje me vlerë të vogël, datë 29.03.2013 me objekt ‘‘Blerje HP Proliant DL 380p’’ me përllogaritjen e fondit limit, 426,287 lekë pa Tvsh dhe me vlerë të tenderuar shuma 398,000 lekë pa tvsh. Në këtë procedurë tenderi është paracaktuar marka e Serverit së bashku me numrin e identifikimit të tij. (Server HP Poliant DL 380p). Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ‘‘Për prokurimin publik’’ kreu III, neni 23, pika 5.

-Në 2 raste të blerjeve të vogla në sistem për vitin 2015 nuk janë bërë 5 ftesa operatorëve ekonomikë sipas VKM nr. 914 datë 29.12.2014, por vetëm 3 ftesa duke eliminuar konkurrencën e lirë (trajtuar më hollësisht në faqet 44 deri 51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

8.1 Nga njësia e prokurimit, të merren masa që për të njëjtin grup artikujsh apo natyrë të njëjtë malli, shërbim apo pune, të mos realizohen dy ose më shumë procedura të ndara veçmas, me qëllim shmangien e përdorimit të procedurave elektronike në kundërshtim me kreun II, neni 8, pika 4, të VKM nr. 914 datë 29.12.2014, ‘‘Për rregullat e Prokurimit Publik’’.

8.2 Të merren masa nga njësia e prokurimit që blerjet me vlera të vogla të planifikohen në fillim të vitit natyra, sasi dhe llojet e kontratave, sipas kërkesave vjetore për blerje mallrash nga sektorët në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, bazuar në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ‘‘Për prokurimin publik’’ i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ‘‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’’ neni 40.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

9. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se, duke patur parasysh që DPSHTRR, është e organizuar me 14 filiale në rrethe dhe është e regjistruar në Tatime me një NIPT dhe për rrjedhojë të gjitha detyrimet për marrëdhëniet me tatimet për TVSH, tatim fitimin, sigurime shoqërore e shëndetësore, TAP, Taksë vjetore të mjeteve të përdorura, Tarifë e pajisjes me leje drejtimi, paguhen nga DPSHTRR, kontabiliteti mbahet i informatizuar për secilën Drejtori më vete dhe veprimet për përmbledhjen e këtyre detyrimeve në DPSHTRR, bëhen me fletë kontabël. Në këto kushte konstatohet se dega e financës nuk ka në dispozicion të instaluar programe informatike për kryerjen e shërbimeve (regjistrim mjeti, leje drejtimi, taksa,

gjoba, etj) (trajtuar më hollësisht në faqet 51 deri 55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

9.1 DPSHTRR dhe Drejtoria Ekonomike, të marrë masa për instalimin e një programi financiar në qendër në lidhje me programet e tjera informatike të drejtorive rajonale, me qëllim lehtësimin e punës, shmangien e gabimeve të mundshme dhe marrjen e të dhënave të sakta financiare.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

10. Gjetje nga auditimi:

Nga të dhënat e bilanceve të audituara u konstatuan subjekte debitorë në veçanti institucione buxhetore dhe ish punonjës që rezultojnë debitorë ndaj të cilëve nuk janë marrë masa për arkëtimin e tyre. (Llog. 411- Gjithsej 7,316,843 lekë, të ndarë: 3,003,241 subjekte buxhetore dhe 4,313,602 lekë, subjekte private. Llog. 467- Gjithsej 8,624,691 lekë, të ndarë: 2,553,330 lekë, punonjës të larguar dhe 6,071,361 lekë, subjekte private) (trajtuar më hollësisht në faqet 51 deri 55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

10.1 DPSHTRR dhe Drejtoria Ekonomike të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për të vënë në lëvizje subjektet që kanë detyrime ndaj këtij institucioni, për të bërë të mundur arkëtimin e tyre si për detyrimet në qendër, ashtu edhe nga Drejtoritë Rajonale.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

11. Gjetje nga auditimi:

-Regjistri i prokurimeve, nuk është hartuar duke pasqyruar të gjitha prokurimet e kryera, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V “Zhvillimi i procedurave” pika 1/c dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” nenet 4 dhe 7 “Regjistri i parashikimit të prokurimeve” dhe “Raportimi i realizimeve”.

-Autoriteti kontraktor ka paraqitur evidencat e parashikimit të prokurimeve në APP, por për vitet 2013-2015, **nuk janë** dërguar evidencat për shtesat dhe ndryshimet, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Referuar evidencave të parashikimit dhe realizimit të prokurimeve për vitet 2013-2016, konstatohet se nga AK, **nuk janë** zhvilluar procedurat e prokurimit sipas parashikimit, por janë zhvilluar procedura me objekt tjetër prokurimi nga parashikimi, **nuk janë** zhvilluar ato të parashikuara dhe **nuk ka** në asnjë rast evidencë për shtesa dhe ndryshime. **Nuk janë** pasqyruar në regjistrin e parashikimit të prokurimeve për vitet 2013-2016, prokurimet me vlera të vogla.

-Për vitin 2015, evidenca e realizimit të prokurimeve është dërguar **me mangësi** janë dubluar disa prokurime duke i pasqyruar si prokurime të kryera më tepër shumë 204,712 mijë lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu I “organizimi i prokurimit publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, nenet 4 dhe 7 “Regjistri i parashikimit të prokurimeve” dhe “Raportimi i realizimeve” (trajtuar më hollësisht në faqet 57 deri 110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

11.1 Njësia e prokurimit të marrë masa që në të ardhmen të hartojë regjistrat e parashikimit të prokurimeve sipas programimit të nevojave për mallra, shërbime dhe punë, duke pasqyruar në çdo rast shtesat dhe ndryshimet e prokurimeve të cilat do të kryhen gjatë vitit në shërbim të aktivitetit të institucionit.

Në vazhdimësi

12. Gjetje nga auditimi:

-Njësia e prokurimit përbëhet nga 4 persona të emëruar të cilët nuk kanë kryer asnjë trajnim mbi prokurimet publike, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V “Zhvillimi i procedurave”, pika 1/b dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 Kreu XII “Manuallet dhe trajnimi” neni 83 (trajtuar më hollësisht në faqet 57 deri 110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

12.1 Autoriteti kontraktor, të marrë masa për të përmirësuar aftësitë profesionale të Njësies së Prokurimit, duke bërë të mundur trajnimin e vazhdueshëm të anëtarëve të Njësies së Prokurimit, nëpërmjet trajnimeve në Agjencinë e Prokurimit Publik, për çështjet e prokurimit publik, në përmbushje të kërkesës së VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në vazhdimësi

13. Gjetje nga auditimi:

-Llogaritja dhe argumentimi i fondeve limit për të gjithë tenderat e zhvilluara për periudhën 2013-2015, **nuk është kryer** nga komisioni i ngritur për këtë qëllim me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor, por është kryer nga Drejtoria Ekonomike. Komisionet e ngritura për llogaritjen e fondit limit, kanë nënshkruar vetëm ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë.

Njësia e prokurimit e këtij autoriteti kontraktor ka në përbërje specialistë juristë dhe ekonomistë, të cilët referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 57 pika 2, duhet të kryejnë edhe përlllogaritjen e fondit limit, në rastet kur kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme (trajtuar më hollësisht në faqet 57 deri 110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

13.1 Autoriteti Kontraktor dhe Njësia e Prokurimit, të marrin masa që në përbërje të grupeve të punës për llogaritjen dhe argumentimin e fondeve limit, për prokurimet që do të kryhen në vazhdim të këtyre specialistëve të fushës referuar objektit të prokurimit dhe specialistëve nga njësia e prokurimit, me qëllim arritjen e kontratave me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet.

Në vazhdimësi

14. Gjetje nga auditimi:

Në regjistrin e parashikimit të prokurimeve **nuk janë parashikuar** për periudhën 2013-2015, prokurimet e zhvilluara me objekt “Blerje letër kimike” në shumën 20,003 mijë lekë, “Blerje pulla takse” në shumën 42,111 mijë lekë, “Blerje prokat leje drejtimi” në shumën 128,637 mijë lekë dhe “Blerje prokat targa” në shumën 110,336 mijë lekë. Këto procedura tenderimi zëne peshën kryesore dhe janë artikuluar kryesor të aktivitetit dhe veprimtarisë së institucionit, prokurime të cilat janë zhvilluar në muajin qershor dhe më tej, duke zhvilluar disa procedura të hapura dhe negocime, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 20.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu I, pika 3/b, Kreu V, pika 1/c, i ndryshuar, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, Kreu VII neni 4, pika 4 dhe neni 57 “Njësia e prokurimit” pika 2 (trajtuar më hollësisht në faqet 57 deri 110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Realizimi i prokurimeve për vitin 2013, për investimet është në nivelin 28%, për shpenzimet 59%.

Realizimi i prokurimeve për vitin 2014, për investimet është në nivelin 14%, për shpenzimet me **një tejkalim** prej 102,014 mijë lekë, nga parashikimi.

Realizimi i prokurimeve për vitin 2015, për investimet është në nivelin 37.5%, për shpenzimet **me një tejkalim** prej 158,754 mijë lekë, nga parashikimi.

Realizimi i prokurimeve për 8 mujorin e vitit 2016, për investimet është në nivelin 7%, për shpenzimet 59%. Veprime të cilat flasin për parashikime apriori dhe të pa bazuara, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014. *(trajtuar më hollësisht në faqet 57 deri 110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për këtë rekomandojmë:

14.1 *Autoriteti Kontraktor, Njësia e Prokurimit dhe Drejtoria Ekonomike, të marrin masa për programimin e saktë dhe të argumentuar të nevojave për investime, duke i pasqyruar në regjistrin e parashikimit të prokurimeve të artikulujve kryesorë si prokat, targa dhe letër kimike, për zhvillimin e aktivitetit dhe realizimin e investimeve, me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuara.*

Në vazhdimësi

15. Gjetje nga auditimi:

-Në dokumentet e tenderëve të audituara në kriteret e veçanta të kualifikimit kërkohet xhiro mesatare vjetore gjatë 3 viteve të fundit, pa përcaktuar xhiron e viteve të marra së bashku apo veç. Në kriteret në lidhje me kapacitetin teknik në tenderët e zhvilluar, janë kërkuar dëshmi për furnizime të mëparshme, kontrata të ngjashme, të shoqëruara me vërtetim për realizimin me sukses të kontratës, nuk janë kërkuar faturat, pasi operatorët ekonomikë pjesëmarrës mund të kenë ushtruar aktivitet jo vetëm në institucionet shtetërore, kriter i cili ka kufizuar mundësinë e pjesëmarrjes së tyre në tender, duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu III, pika 3/b.

-Në dokumentet e tenderëve të audituara, të hartuara dhe miratuara nga autoriteti kontraktor, në kriteret e kualifikimit “kapaciteti teknik”, nuk është kërkuar asnjë kërkesë tjetër në lidhje me kapacitetin teknik të operatorit ekonomik, por kërkohet vetëm certifikatat e prodhuesit dhe nuk ka kriteret të tjera për operatorin ekonomik pjesëmarrës në lidhje me licencat profesionale, etj, kriteret të nevojshme, kërkesa të domosdoshme për arritjen e punëve, mallrave dhe shërbimeve sipas kushteve të kontratës, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 46 “Kualifikimi i kandidatëve” dhe VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

-Në të gjithë tenderët e audituar kriteret e veçanta të kualifikimit janë kopje e DST-ve të cilat në përmbajtje kanë kërkesa minimale për kryerjen e punëve, mallrave apo shërbimeve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 46 “kualifikimi i ofertuesve” dhe VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu 5 pika 2/a. Argumentimi i bërë për vendosjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit është formal, nuk është referuar objektit të prokurimit dhe asaj se çfarë kërkon autoriteti kontraktor, por jepen shpjegime se këto kriteret kështu janë përcaktuar në dokumentet e tenderit dhe se njësia thjesht ka bërë rumbullakime *(trajtuar më hollësisht në faqet 57 deri 110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për këtë rekomandojmë:

15.1 *Njësia e Prokurimit, për të ardhmen, të marrë të gjitha masat, që kërkesat e veçanta për kualifikim të hartohen në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit, të përcaktohen kriteret kualifikimi të sakta dhe të kuptueshme, pa lënë shteg për interpretime, si dhe të detajohen sipas rregullave të prokurimit publik. Kërkesat kualifikuese të veçanta, të hartuara e miratuara nga autoriteti kontraktor duhet të jenë të argumentuara dhe në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim arritjen e konkurrencës së nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe punëve, për të arritur rezultate të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike.*

Në vazhdimësi

16. Gjetje nga auditimi:

Në prokurimet e zhvilluara autoriteti kontraktor në procedurat me negociim pa shpallje, ka ftuar të njëjtët operatorë ekonomikë, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 33 “procedura me negociim pa shpallje, pika 6. Megjithëse konstatohet se në disa raste ofertat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur me mangësi të tilla, si nuk kanë paraqitur ofertën, nuk kanë paraqitur dokumente elementare për pjesëmarrje në prokurime si regjistrimin në QKR, ose kontrata të ngjashme duke sjellë anulimin, dështimin në kryerjen e punëve mallrave dhe shërbimeve dhe tejzgjatjen e pa argumentuar të procedurave dhe në këto kushte janë ftuar vazhdimisht nga autoriteti kontraktor për të marrë pjesë në prokurime (*trajtuar më hollësisht në faqet 57 deri 110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

16.1 Autoriteti Kontraktor, të marrë masa që në procedurat “me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” të dërgojë ftesa për negociim një numri të madh operatorësh ekonomik që operojnë në fushën për objektin e prokurimit, me qëllim arritjen e konkurrencës dhe kontratave me efektivitet të lartë.

Në vazhdimësi

17. Gjetje nga auditimi:

-Në tenderat e zhvilluar me objekt “Blerje prokat leje drejtimi viti 2014” me fond limit 13,314 mijë lekë, “Blerje prokat leje drejtimi viti 2014” me fond limit 22,259 mijë lekë, “Mirëmbajtja e sistemeve të lejeve të drejtimit viti 2015” me fond limit 5,194 mijë lekë dhe “Blerje prokat leje drejtimi viti 2016” me fond limit 30,780 mijë lekë, komisioni i vlerësimit të ofertave ka shpallur fitues operatorin ekonomik “█” pa plotësuar një nga kriteret e përgjithshme për kualifikim, sepse objekti i përcaktuar për zhvillimin e aktivitetit në regjistrin tregtar për të dhënat e subjektit “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” **nuk ka** të përfshirë aktivitetin për të cilin operatori ekonomik “█” ka ofertuar dhe është shpallur fitues për 11 vite rresht.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje pulla viti 2014” me fond limit 834 mijë lekë, komisioni i vlerësimit të ofertave ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorin ekonomik “█”, i cili nuk plotëson një nga kriteret e veçanta për kualifikim, “kapaciteti teknik”, sepse kontratën e ngjashme e ka paraqitur si bashkim operatorësh dhe nuk është përcaktuar % e pjesëmarrjes në kontratën e bashkëpunimit.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje shtypshkrime viti 2014” me fond limit 13,811 mijë lekë, komisioni vlerësimit të ofertave ka kualifikuar operatorin ekonomik “█” pa plotësuar kushtin e paraqitjes së vërtetimit të debisë për pagesat e energjisë elektrike, sepse vërtetimi daton më 18.07.2014 dhe konfirmon pagesën e energjisë deri në muajin qershor ndërsa tenderi është zhvilluar në 01.09.2014, në kundërshtim me dokumentet e tenderit dhe VKM nr. 379, datë 11.06.2014 “Për disa shtesa në VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 57 deri 110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

17.1 Autoriteti Kontraktor të marrë masa, që në përbërje të komisioneve të vlerësimit të ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të caktohen anëtarë të KVO-ve vetëm specialistë të fushës, sipas objektit të prokurimit, kjo në respektim të kërkesave të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në vazhdimësi

18. Gjetje nga auditimi:

Në tenderin e zhvilluar me objekt “Mirëmbajtja e sistemit të lejeve të drejtimit viti 2015” me fond limit 5,194 mijë lekë, u konstatua se:

-Për llogaritjen e fondit limit janë kërkuar 3 oferta nga operatorët ekonomikë: “█” “█” dhe “█”, llogaritja e fondit limit është mesatarja aritmetike e 3 ofertave pa asnjë argumentim të fondit limit. Po kështu nuk ka informacion në lidhje me aktivitetin që ushtrojnë 3 kompanitë të cilave ju është kërkuar oferta, sepse kompania “█” ushtron aktivitetin për sistemet e sigurisë dhe jo mirëmbajtje makinerie prodhim leje drejtimi.

-Në dokumentet e tenderit “kriteret e veçanta për kualifikim”, kapaciteti teknik, pika B.2, licencat profesionale, është kërkuar që operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me autorizimin e prodhuesit apo implementuesit të linjës së personalizimit të lejeve të drejtimit kombëtare, për mirëmbajtjen e linjës së personalizimit.

Një kërkesë e tillë të çon patjetër në përcaktimin e kompanisë fituese, sepse dihet që “█”, ka ekskluzivitetin nga kompania implementuese dhe asnjë operator tjetër ekonomik, e konfirmuar edhe nga fakti se në ditën e hapjes së tenderit është paraqitur vetëm operatori ekonomik “█”. Po kështu sipas autorizimit të prodhuesit “█”, datë 07.09.2015, autorizon kompaninë “█”, për të negociuar dhe lidhë kontratën për mirëmbajtjen e sistemit të prodhimit të lejeve të implementuar nga ajo. Asnjë kompani tjetër përveç “█” nuk është e autorizuar të nënshkruajë kontratë për sistemin e tyre.

-Në kriteret e veçanta të kualifikimit nuk janë kërkuar në lidhje me aftësitë teknike, kërkesa si kualifikimet e nevojshme, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet përvoja e duhur, personeli, etj, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 46 “kualifikimi i ofertuesve” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 28 “Kontratat e shërbimeve”.

-Objekti i përcaktuar për zhvillimin e aktivitetit në regjistrin tregtar për të dhënat e subjektit “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” **nuk ka** të përfshirë aktivitetin për të cilin operatori ekonomik “█” ka ofertuar dhe është shpallur fitues. Komisioni i vlerësimit të ofertave ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorin ekonomik “█” i cili nuk plotëson një nga kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kriterin e mirëmbajtjes duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 46 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ‘për miratimin e rregullave të prokurimit publik’, neni 15 dhe dokumentet Standarde të tenderit (*trajtuar më hollësisht në faqet 57 deri 110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

18.1 *Njësia e prokurimit dhe komisionet e ngritura për hartimin e dokumenteve të tenderit, llogaritjen e fondit limit dhe ftesat për ofertë, të marrin masa për njohjen me aktivitetin që ushtrojnë operatorët ekonomikë i cili duhet të jetë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim arritjen e kontratave me cilësi, efektivitet dhe efikasitet.*

Në vazhdimësi

19. Gjetje nga auditimi:

Nga ana e Drejtorisë së Kualifikimeve Profesionale në DPSHTRR, nuk janë zhvilluar trajnime dhe testime për zhvillimin e kapaciteteve profesionale me të gjithë stafin e DPSHTRR, nuk janë marrë masa për përcaktimin në rregullore të brendshme, specifikime lidhur me përzgjedhjen, emërimin dhe përcaktimin e pagës dhe të shpërblimeve për punonjësit apo lidhur me vlerësimin e performancës dhe vendosjen e sanksioneve në rast të mos përmbushjes së detyrave, përkrahje pune për çdo pozicion në institucion, në të cilat të përfshihen detyrat individuale që duhen kryer, kërkesat lidhur me kualifikimet e nevojshme dhe linjat e raportimit, nuk janë marrë masa për kryerjen e vlerësimeve periodike të punonjësve në institucion, lidhur me detyrat që ata kryejnë si pjesë e përgjegjësisë të tyre, nuk janë marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së riskut apo përcaktimi i procedurave për menaxhimin e riskut dhe nuk është krijuar një regjistër risku të shkruar që përfshin risqet më të rëndësishme të lidhura me objektivat e njësive (*trajtuar më hollësisht në faqet 110 deri 120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

19.1 Drejtoria e Kualifikimeve Profesionale në DPSHTRR të marrë masat e duhura për zhvillimin e trajnimeve dhe testeve për zhvillimin e kapaciteteve profesionale me të gjithë stafit e DPSHTRR, të marrë masat e duhura për përcaktimin në rregullore të brendshme specifike lidhur me përzgjedhjen, emërimin dhe përcaktimin e pagës dhe të shpërblimeve për punonjësit apo lidhur me vlerësimin e performancës dhe vendosjen e sanksioneve në rast të mos përmbushjes së detyrave, përshkrime pune për çdo pozicion në institucion, në të cilat të përfshihen detyrat individuale që duhen kryer, kërkesat lidhur me kualifikimet e nevojshme dhe linjat e raportimit, të marrë masat e duhura për vlerësimet periodike të punonjësve në institucion, lidhur me detyrat që ata kryejnë si pjesë e përgjegjësisë të tyre, të marrë masat e duhura për hartimin dhe miratimin e strategjisë së riskut, përcaktimin e procedurave për menaxhimin e riskut dhe krijimin e një regjistri risku të shkruar që përfshin risqet e lidhura me objektivat e njësisë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

20. Gjetje nga auditimi:

Gjatë shërbimeve të radhës që kryejnë pronarët apo drejtuesit e mjeteve në sportelet e DPSHTRR, nuk u kërkohet dokument që vërteton se, nuk kanë detyrime ndaj organeve të policisë rrugore për gjopa nga kondravajtjet administrative. Mungesa e këtij rakordomi sjell shmangien e këtyre gjobave, pasi mjete humbet gjurmët lehtësisht duke ndërruar targën pikërisht vetëm për shkak të gjobave të papaguara (*trajtuar më hollësisht në faqen 120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

20.1 DPSHTRR të marrë masa që të bashkëpunohet me organet e policisë së shtetit, me qëllim paraqitjen reciproke të dokumenteve që të vërtetojnë shlyerjen e detyrimeve të ndërsjella të të dy institucioneve (të lidhin marrëveshje).

Në vazhdimësi

B 1. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi:

Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje mjete transporti viti 2014” është shtyrë afati i lëvrimin të mallit nëpërmjet amendamentit të kontratës së datës 27.10.2014.

Në datën 20.10.2014, është paraqitur një kërkesë nga operatori ekonomik ■■■, ku kërkohet ndjesë në lidhje me realizimin e kontratës së datës 25.08.2014 dhe kërkohet shtyrja e afatit deri në datën 15.12.2014, me argumentin se do të plotësojnë specififikimet e kërkuara. Kjo kërkesë është bërë jashtë afateve ligjore sepse kontrata duhej të përfundonte në datën 10.10.2014, ndërkohë që amendamenti i kontratës për shtyrjen e afatit është bërë në datën 27.10.2014.

Në datën 28.07.2014, operatori ekonomik ka paraqitur një shkresë nga kompania prodhuese ku citohet se: “*ne do të ruajmë shërbimin normal të funksionimit logjistike deri në 22 gusht, ora 18.00 për shkak të mirëmbajtjes së sistemit, prandaj duhet të keni parasysh se prodhimi do të ndërpritet në 14 gusht. Porositë e konfirmuara për prodhimin deri në fund të korrikut do të prodhohen para mbylljes. Çdo porosi tjetër e vënë në sistem pas 1 gushtit do të jetë në prodhim pas mbylljes. Kërkojmë ndjesë dhe shpresojmë në mirëkuptimin tuaj për çdo vonesë në porositë, prodhimin dhe ngarkimin gjatë kësaj kohe. Ju sjellim në vëmendje funksionimin normal në datën 08.09.2014”.*

Pra, operatori ekonomik ■■■ ka qenë në dijeni 1 muaj para nënshkrimit të kontratës me autoritetin kontraktor që kompania prodhuese nuk mundësonte prodhimin e makinave sipas kontratës që ka nënshkruar në datën 25.08.2014.

Në këto kushte nuk plotësohen rrethanat e përcaktuara në amendamentin shtesë të kontratës për shtyrjen e afatit të lëvrimin. Amendamenti i kontratës është i pa justifikuar

dhe në kundërshtim me DST neni 23, nuk jemi në rastin kur duhet pranuar shtyrja e afatit sepse nuk është e argumentuar ligjërisht.

Shuma 5,080,842 lekë, penalitet për vonesën e cila nuk është kërkuar, duke favorizuar operatorin ekonomik [] nëpërmjet amendamentit të kontratës për shtyrjen e afatit. (trajtuar më hollësisht në faqet 67 deri 70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

1.1 Autoriteti kontraktor të marrë të gjitha masat dhe të ndjekë rrugën ligjore për arkëtimin e shumës prej **5,080,842 lekë**, nga operatori ekonomik "[]" për penalitetin e pa ndalur për vonesën në lëvrimin e mallit, ndaj operatorit ekonomik "[]", në tenderin e zhvilluar me objekt "Blerje mjete transporti për vitin 2014".

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi:

Në punimet realizuara në bazë të kontratës së sipërmarrjes nr. 2991 prot., datë 28.03.2013, ndërmjet autoritetit kontraktor, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe kontraktorit, operatorit ekonomik "[]" SHPK. Vlera e kontratës së lidhur është 5,246,182 lekë pa TVSH. Afati i realizimit të punimeve është 45 ditë kalendarike.

Autoritetit Kontraktor mbas afatit së përfundimit të punimeve, (të cilat duhet të përfundonin më datë 15.05.2015, njoftimi për përfundimin e punimeve 5 ditë më parë) nuk ka vepruar në përputhje me pikën "a", të nenit 35 të kontratës: "...për çdo ditë vonese tej afatit të punimeve. Kontraktori është i detyruar t'i paguaj investitorit, gjobë në masën 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës". Deri më datë 08.11.2013 nuk ka njoftim për përfundimin e punimeve të kontratës bazë, pra afati i përfundimit të punimeve ka vonesë 177 ditë ($25\% \times 5,246,182 \text{ lekë} = 1,311,545.50 \times 4/1000 \times 177 =$) 928,574 lekë me tvsh është penalitet që duhej të paguante operatori ekonomik "[]" SHPK. Shuma **928,574** lekë me tvsh është e ardhur e munguar me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit (trajtuar më hollësisht në faqet 104 deri 110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

2.1 Të merren masat nga DPTSHRR duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik në vlerën **928,574 lekë** me tvsh nga operatori ekonomik "[]" SHPK.

Menjëherë

B 2. SHPENZIME DHE TË ARDHURA JO NË PËRPUTHJE ME PARIMET E EKONOMICITETIT, EFICENSËS DHE EFEKTIVITETIT.

1. Gjetje nga auditimi:

Këshilli Drejtues, ka vendosur që nga fondet e DPSHTRR si ent publik me vetëfinancim, të paguhen edhe pjesa takuese e fondit vullnetarë të pensioneve në mënyrë të barabartë me pjesën që paguan vullnetarisht çdo punonjës. Pra në total kemi, fonde për skemën e sigurimeve vullnetare dhe për kontributet e bëra nga DPSHTRR-ja në interes të punonjësve të tij në vlerën **13,327,977 lekë, shumë e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e DPSHTRR**, në kundërshtim me nenin 9 të Statutit të miratuar të DPSHTRR, nenit 54 të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 dhe Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 (trajtuar më hollësisht në faqet 30 deri 37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

1.1 Nga DPSHTRR, të merren masa që pagesat për sigurimet vullnetare të punonjësve, vetëm pas miratimeve përkatëse konform kërkesave ligjore, të trajtohen si të ardhura të punonjësve duke derdhur për to tatimin mbi të ardhurat në rastet e tejkalimit të kufijve të

vendosur në nenin 84/4 dhe 88/5 të ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensioneve vullnetare”.

Në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi:

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për periudhën e auditimit në 40 raste, si rezultat i largimeve nga puna pa shkaqe të arsyeshme, ka kryer pagesa page për vendime gjyqësore në vlerën **34,541,074 lekë, e cila përbën efekt negativ financiar për të ardhurat e DPSHTRR** (trajtuar më hollësisht në faqet 37 deri 44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

2.1 DPSHTRR të ndjekë në të gjitha shkallët e gjyqimit, për dëmshpërblimet, për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, në mënyrë që këto vendime të mos jenë në shumicën e rasteve në favor të punonjësve të larguar dhe në të ardhmen të shkaktojnë rëndim të situatës financiare të shoqërinë, duke cenuar zhvillimin normal të aktivitetit ekonomiko-financiar.

Në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi:

Pas shqyrtimit dhe llogaritjes të kilometrave të kryer nga secili automjet, sasia prej 2,523 litra karburant në vlerën prej **454,392 lekë**, ka sjell një **efekt negativ financiar për institucionin** dhe është e pa rakorduar me dokumentacionin përkatës, duke u bazuar në distancat e përshkruara në fletë udhëtimet e çdo muaji dhe duke i krahasuar ato me distancat zyrtare të përcaktuara në Urdhrin e Ministrit të PPT nr. 125, datë 26.12.2011 (në fuqi) “Për miratimin e hartave të azhurnuara të Rrjetit Rrugor Kombëtar dhe distancave kilometrike ndërmjet qyteteve në RSH” (trajtuar më hollësisht në faqet 37 deri 44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

3.1 Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa që fletët e udhëtimeve për shërbimet e kryera, të pasqyrojnë saktë kilometrat e përshkuara justifikuar me sasinë e karburantit të tërhequr nga magazina, duke u bazuar në distancat zyrtare të përcaktuara në Urdhrin e Ministrit të PPT nr. 125, datë 26.12.2011 (në fuqi) “Për miratimin e hartave të azhurnuara të Rrjetit Rrugor Kombëtar dhe distancave kilometrike ndërmjet qyteteve në RSH”.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi:

Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje targa prokat” me fond limit 49,255 mijë lekë, llogaritja e fondit limit është bërë me çmim më të lartë/njësi për të katërt artikujt për targat **në shumën 15,647 mijë lekë, nga përvoja e vitit të kaluar, duke sjellë efekt negativ për institucionin.**

Llogaritja e fondit limit nuk është argumentuar pse janë marrë ofertat më të larta dhe pa u bazuar në përvojën e mëparshme, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu II pika 2/ç. Referuar VKM dhe ligjit të prokurimit publik, komisioni i llogaritjes së vlerës limit të kontratës nuk ka analizuar çmimet për të arritur një kontratë me efektivitet dhe me vlerë më të ulët, duke respektuar parimet e prokurimit dhe një nga kriteret kryesore arritjen e prokurimit të mallrave sipas specifikimeve të kërkuara me çmim sa më të ulët.

-Llogaritja e fondit limit nuk është korrekte dhe e argumentuar, sepse janë marrë të njëjtat oferta nga të njëjtët operatorë ekonomikë me të njëjtat çmime për të gjithë tenderët e zhvilluara për vitin 2014 me objekt “Blerje prokat”

Autoriteti kontraktor në llogaritjen e fondit limit mban qëndrim të ndryshëm nga një tender në një tender tjetër, sepse në disa raste për llogaritjen e fondit limit i referohet çmimit të

kontratave të realizuara një vit më parë dhe në disa tenderë nxjerr mesataren aritmetike të përvojës së vitit të kaluar me disa oferta të marra nga operatorët ekonomikë, të cilat janë disa herë më të larta, duke mos dhënë asnjë argument apo sqarim (*trajtuar më hollësisht në faqet 57 deri 110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

4.1 Autoriteti Kontraktor dhe Njësia e Prokurimit, të marrin masa që për llogaritjen dhe argumentimin e fondeve limit, për prokurimet që do të kryhen në vazhdim, të argumentojnë dhe analizojnë në çdo rast çmimet, për të arritur një kontratë me efektivitet, duke respektuar parimet e prokurimit dhe një nga kriteret kryesore arritjen e prokurimit të mallrave, punëve e shërbimeve sipas specifikimeve të kërkuara, me çmim sa më të ulët, me qëllim arritjen e kontratave me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet.

Në vazhdimësi

5. Gjetje nga auditimi:

Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje shtypshkrime viti 2014” me fond limit 13,811 mijë lekë, u konstatua:

-Komisioni ka llogaritur fondin limit në datën 25.07.2014, bazuar në ofertat e marra dhe përvojën e vitit të kaluar duke nxjerrë mesataren e tyre, dhe shprehet se janë bazuar në çmimet e ofertave pa dhënë asnjë shpjegim ose argumentim përse janë marrë ofertat më të larta për llogaritjen e fondit limit, në një kohë që ka qenë përvoja e mëparshme me çmim më të ulët. Komisioni ka llogaritur fondin limit në shumën 9,705 mijë lekë, ose 3,636 mijë lekë, më të lartë nga përvoja e vitit të kaluar.

Referuar VKM dhe ligjit të prokurimit publik, komisioni i llogaritjes së vlerës limit të kontratës nuk ka analizuar çmimet për të arritur një kontratë me efektivitet dhe me vlerë më të ulët duke respektuar parimet e prokurimit dhe një nga kriteret kryesore arritjen e prokurimit të mallrave sipas specifikimeve të kërkuara me çmim sa më të ulët.

Argumentimi dhe përlllogaritja e fondit limit, është bërë përsëri pas 4 ditëve me shkresën nr. 891/1 port, datë 29.07.2014, nga Drejtori Ekonomik dhe ekonomistja e programimit bazuar në testimin e tregut, eksperiencën e mëparshme dhe pas mbërritjes së 2 ofertave të tjera rreth 2 herë më të larta, nga 2 operatorë ekonomik “■” dhe “■”, duke ndryshuar fondin e llogaritur nga komisioni i specifikimeve teknike dhe llogaritjes së fondit limit i caktuar nga titullari i autoritetit kontraktor. Drejtori ekonomik dhe ekonomistja e programimit janë njëherazi edhe anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave, dhe kanë vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 20.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vlera e fondit limit është rritur artificialisht brenda 4 ditëve në shumën 4,104,440 lekë, **duke shkaktuar efekt ekonomik për institucionin në shumën 1,658,880 lekë, me tvsh (11,088,000-9,705,600)** me shkresën e nënshkruar nga drejtori ekonomik dhe specialistja e programimit, i cili në këtë rast ka tejkalluar kompetencat duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V “Zhvillimi i procedurave” pika 2/c dhe me vetë urdhrin e titullarit të autoritetit kontraktor (*trajtuar më hollësisht në faqet 70 deri 73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6. Gjetje nga auditimi:

Në vitin 2013, kemi në total një numër prej 445.956 mjetesh, nga të cilat 332.631 mjete kanë paguar taksat vjetore. Numri i mjeteve që nuk kanë paguar taksa është 113,325 në vlerën prej **433,611,094 lekë**, shumë e **cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e DPSHTRR.**

Në vitin 2014, kemi në total një numër prej 490.899 mjetesh, nga të cilat 369.590 mjete kanë paguar taksat vjetore. Numri i mjeteve që nuk kanë paguar taksa është

121.309 në vlerën prej **236,171,721 lekë**, shumë e **cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e DPSHTRR.**

Në vitin 2015, kemi në total një numër prej 522.066 mjetesh, nga të cilat 408.671 mjete kanë paguar taksat vjetore. Numri i mjeteve që nuk kanë paguar taksa është 113.395 në vlerën prej **373,738,265 lekë**, shumë e **cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e DPSHTRR** (trajtuar më hollësisht në faqet 55 deri 57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

6.1 DPSHTRR të bashkëpunojë me organet e policisë së shtetit dhe organet tatimore, me qëllim paraqitjen reciproke të dokumenteve që të vërtetojnë shlyerjen të detyrimeve të ndërsjellat të të dy institucioneve, gjë që do të ndikojë edhe në pagesat e taksave vjetore të makinave dhe do të rrisë të ardhurat e buxhetit të institucionit.

6.2 DPSHTRR të bashkëpunojë, me koncesionarin (kompania ku kryhet kolaudimi i mjeteve), për të gjetur mënyrën e zgjidhjes që automjetet të cilat nuk paguajnë taksat vjetore, detyrimisht duhet të shmangin kontrollin teknik të detyrueshëm, e për pasojë pagimin e tarifave për këtë shërbim.

Në vazhdimësi

7. Gjetje nga auditimi:

Janë zhvilluar procedura “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” për tenderët me objekt “Blerje targa prokat viti 2014” me fond limit 49,255 mijë lekë, “Blerje targa prokat viti 2014” me fond limit 22,259 mijë lekë, “Blerje pulla takse viti 2014” me fond limit 834 mijë lekë, “Blerje prokat viti 2014” me fond limit 13,314 mijë lekë dhe “Blerje pulla takse viti 2015” me fond limit 1,386 mijë lekë.

Përzgjedhja e procedurës “Me negocim pa shpallje paraprake”, është e pa argumentuar dhe në shkelje të plotë me ligjin e prokurimit publik nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, nenin 33/2, germa “c”, si dhe me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pika 5/a. Autoriteti kontraktor ka pasur në dispozicion kohën e nevojshme për zhvillimin e procedurave normale të prokurimit dhe nuk plotësohen kushtet e një situatë ekstreme.

Në tenderin “Blerje prokat viti 2014” me fond limit 13,314 mijë lekë, çmimi i ofruar nga ■■■ është 82, 65 lekë/cope më i lartë se çmimi i paraqitur po nga operatori ekonomik ■■■ në ofertën e sjellë për konkurrim në tenderin e hapur në datën 30.06.2014. Pra, **vlera prej 1,487,700 lekë, përbën të ardhura të munguara për autoritetin kontraktor**, sepse nëse do të planifikonte drejt nevojat këtë sasi do ta prokuronte në tenderin e hapur me çmim ofertë më të ulët. (trajtuar më hollësisht në faqet 57 deri 110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

7.1 Autoriteti Kontraktor të marrë të gjitha masat, për prokurimin e shërbimeve dhe mallrave në sistemin elektronik, ta fillojë në kohën e duhur, për të mundësuar shmangien e procedurës së prokurimit “me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” me qëllim rritjen e konkurrencës dhe përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike. Autoriteti kontraktor të marrë masa, që në procedurën e tenderit të përdorur “me negocim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës”, të bëhen negociimet përkatëse me operatorët ekonomikë konkurrues dhe jo të shpallet fituesi aq sa është vlera e fondit limit, i përcaktuar nga autoriteti kontraktor si dhe të kalojnë me rigorozitet të gjitha hapat që janë përcaktuar. Kjo në respektim të legjislacionit të prokurimit publik, e konkretisht të Manualit të APP, pika 3.2.

Në vazhdimësi

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 37,141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, Statutit të DPTR neni 10.6 “Dhënie mase disiplinore” dhe rregullores së Personelit Kapitulli IX, neni 45 “Masat disiplinore, aplikimi dhe llojet e tyre”, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm, që të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

“Vërejtje” deri “Largim nga puna”, për:

1. A.G. me detyrë shefe sektorit të prokurimeve, për arsye se:

-Nuk ka hartuar e pasqyruar të gjitha prokurimet e kryera në regjistrin e parashikimit të prokurimeve, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V “Zhvillimi i procedurave” pika 1/c dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” nenet 4 dhe 7 “Regjistri i parashikimit të prokurimeve” dhe “Raportimi i realizimeve”.

-Nuk ka dërguar evidencat për shtesat dhe ndryshimet në regjistrin e prokurimeve për vitet 2013-2015, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Nuk ka zhvilluar procedurat e prokurimit sipas parashikimit, por ka zhvilluar procedura me objekt tjetër prokurimi nga parashikimi.

-Nuk ka parashikuar në regjistrin e parashikimit të prokurimeve për periudhën 2013-2015, prokurimet e zhvilluara me objekt “Blerje letër kimike” në shumën 20,003 mijë lekë, “Blerje pulla takse” në shumën 42,111 mijë lekë, “Blerje prokat leje drejtimi” në shumën 128,637 mijë lekë dhe “Blerje prokat targa” në shumën 110,336 mijë lekë. Këto procedura tenderimi zënë peshën kryesore dhe janë artikujt kryesor të aktivitetit dhe veprimtarisë së institucionit, prokurime të cilat janë zhvilluar në muajin qershor dhe më tej, duke zhvilluar disa procedura të hapura dhe negocime, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 20.01.2007, Kreu I, pika 3/b, Kreu V, pika 1/c, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, Kreu VII neni 4, pika 4 dhe neni 57 “Njësia e prokurimit” pika 2.

-Ka zhvilluar procedura “negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” për tenderat me objekt “Blerje targa prokat viti 2014” me fond limit 49,255 mijë lekë, “Blerje targa prokat viti 2014” me fond limit 22,259 mijë lekë, “Blerje pulla takse viti 2014” me fond limit 834 mijë lekë, “Blerje prokat viti 2014” me fond limit 13,314 mijë lekë dhe “Blerje pulla takse viti 2015” me fond limit 1,386 mijë lekë, të pa argumentuara pa u plotësuar kushtet e një situatë ekstreme dhe në shkelje të plotë me ligjin e prokurimit publik nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 33/2, germa “c”, si dhe me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 pika 5/a.

-Nuk ka hartuar drejt kriteret e veçanta të kualifikimit, kapacitetin teknik, etj kriteret duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 46 “Kualifikimi i kandidatëve” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu III, pika 3/b.

-Ka ftuar të njëjtët operatorë ekonomikë në prokurimet e zhvilluara në procedurat me negocim pa shpallje, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 33 “procedura me negocim pa shpallje, pika 6.

-Ka zhvilluar tendera me objekt “Blerje autovetura për administratën për vitet 2014 dhe 2015”, pa pasur në dispozicion kërkesat për nevojat e mjeteve, e cila është baza për fillimin e një procedure prokurimi, në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

-Nuk ka pasqyruar në regjistrin e parashikimit të prokurimeve për vitet 2013-2016, prokurimet me vlera të vogla.

2. A.D. juriste në njësinë e prokurimit, për arsye se:

-Nuk ka parashikuar në regjistrin e parashikimit të prokurimeve për periudhën 2013-2015, prokurimet e zhvilluara me objekt “Blerje letër kimike” në shumën 20,003 mijë lekë, “Blerje pulla takse” në shumën 42,111 mijë lekë, “Blerje prokat leje drejtimi” në shumën 128,637 mijë lekë dhe “Blerje prokat targa” në shumën 110,336 mijë lekë. Këto procedura tenderimi zënë peshën kryesore dhe janë artikujt kryesor të aktivitetit dhe veprimtarisë së institucionit, prokurime të cilat janë zhvilluar në muajin qershor dhe më tej, duke zhvilluar disa procedura të hapura dhe negociime, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 20.01.2007, Kreu I, pika 3/b, Kreu V, pika 1/c, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, Kreu VII neni 4, pika 4 dhe neni 57 “Njësia e prokurimit” pika 2.

-Ka zhvilluar procedura “negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” për tenderat me objekt “Blerje targa prokat viti 2014” me fond limit 49,255 mijë lekë, “Blerje targa prokat viti 2014” me fond limit 22,259 mijë lekë, “Blerje pulla takse viti 2014” me fond limit 834 mijë lekë, “Blerje prokat viti 2014” me fond limit 13,314 mijë lekë dhe “Blerje pulla takse viti 2015” me fond limit 1,386 mijë lekë, të pa argumentuara pa u plotësuar kushtet e një situatë ekstreme dhe në shkelje të plotë me ligjin e prokurimit publik nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 33/2, germa “c”, si dhe me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 pika 5/a.

-Nuk ka hartuar drejt kriteret e veçanta të kualifikimit, kapacitetin teknik, etj kriteret duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 46 “Kualifikimi i kandidatëve” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu III, pika 3/b.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje mjete transporti viti 2014” ka shtyrë afatin e lëvrimin të mallit nëpërmjet amendamentit të kontratës së datës 27.10.2014, pa u plotësuar kushtet e përcaktuara në amendamentin shtesë për shtyrjen e afatit të lëvrimin, duke favorizuar operatorin ekonomik “■” për shumën 5,080,842 lekë, penaltit për vonesën.

-Ka zhvilluar tendera me objekt “Blerje autovetura për administratën për vitet 2014 dhe 2015”, pa pasur në dispozicion kërkesat për nevojat e mjeteve, e cila është baza për fillimin e një procedure prokurimi, në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

-Nuk ka pasqyruar në regjistrin e parashikimit të prokurimeve për vitet 2013-2016, prokurimet me vlera të vogla.

3. A.D. specialist në njësinë e prokurimit, për arsye se:

-Ka zhvilluar procedura “negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” për tenderat me objekt “Blerje targa prokat viti 2014” me fond limit 49,255 mijë lekë, “Blerje targa prokat viti 2014” me fond limit 22,259 mijë lekë, “Blerje pulla takse viti 2014” me fond limit 834 mijë lekë, “Blerje prokat viti 2014” me fond limit 13,314 mijë lekë dhe “Blerje pulla takse viti 2015” me fond limit 1,386 mijë lekë, të pa argumentuara pa u plotësuar kushtet e një situatë ekstreme dhe në shkelje të plotë me ligjin e prokurimit publik nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 33/2, germa “c”, si dhe me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 pika 5/a.

-Nuk ka hartuar drejt kriteret e veçanta të kualifikimit, kapacitetin teknik, etj kriteret duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 46 “Kualifikimi i kandidatëve” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu III, pika 3/b.

-Ka ftuar të njëjtët operatorë ekonomikë në prokurimet e zhvilluara në procedurat me negociim pa shpallje, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 33 “procedura me negociim pa shpallje, pika 6.

-Ka zhvilluar tendera me objekt “Blerje autovetura për administratën për vitet 2014 dhe 2015”, pa pasur në dispozicion kërkesat për nevojat e mjeteve, e cila është baza për fillimin e një procedure prokurimi, në kundërshtim me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

4. R.D. me detyrë drejtor ekonomik, në cilësinë e anëtarit të KVO, për arsye se:

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “**Blerje targa prokat viti 2014**” me fond limit 49,255 mijë lekë, ka kualifikuar operatorin ekonomik , i cili ka paraqitur certifikatën e cilësisë ISO 9001; 2008 jashtë afateve, në kundërshtim me kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.a dhe nenin 53 pika 3 të ligjit për prokurimin publik.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje shtypshkrime viti 2014” me fond limit 3,811 mijë lekë, ka kualifikuar operatorin ekonomik “■” pa plotësuar kushtin e paraqitjes së vërtetimit të debisë për pagesat e energjisë elektrike, në kundërshtim me dokumentet e tenderit dhe VKM nr. 379, datë 11.06.2014 “Për disa shtesa në VKM nr.1, datë 10.01.2007.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “**Blerje shtypshkrime viti 2014**” me fond limit 13,811 mijë lekë, ka rillogaritur fondin limit, duke ndryshuar fondin e llogaritur nga komisioni i specifikimeve teknike dhe llogaritjes së fondit limit i caktuar nga titullari i autoritetit Kontraktor në shumën 4,104,440 lekë, duke shkaktuar efekt ekonomik negativ për institucionin në shumën 1,658,880 lekë, me tvsh. Drejtori ekonomik është njëherazi edhe kryetar i komisionit të vlerësimit të ofertave, në këtë rast ka tejkaluar kompetencat duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu V “Zhvillimi i procedurave” pika 2/c dhe me vetë urdhrin e titullarit të autoritetit Kontraktor.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “**Blerje pulla**”, me fond limit 834 mijë lekë, ka kërkuar të prokurohet për nevoja urgjente sasia prej 60,000 copë pulla dhe ka llogaritur fondin limit duke tejkaluar kompetencat, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe VKM nr.1, datë 20.01.2007, Kreu V, pika 2/c dhe me vetë urdhrin e titullarit të autoritetit kontraktor, ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorin ekonomik “■”, i cili nuk plotëson një nga kriteret e veçanta për kualifikim, “kapaciteti teknik”, sepse kontratën e ngjashme e ka paraqitur si bashkim operatorësh dhe nuk është përcaktuar % e pjesëmarrjes në kontratën e bashkëpunimit.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “**Blerje prokat viti 2016**”, me fond limit 30,780 mijë lekë, ka shpallur fitues operatorin ekonomik “■” i cili nuk ka të përfshirë në objektin e veprimtarisë në QKR, aktivitetin për të cilin ka ofertuar, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorin ekonomik pa plotësuar kriteret e kualifikimit, në lidhje me afatin e lëvrimit, në kundërshtim me dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga autoriteti kontraktor.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “**Mirëmbajtja e sistemit të lejeve të drejtimit**”, me fond limit 5,194 mijë lekë, ka shpallur fitues operatorin ekonomik “■” i cili nuk ka të përfshirë në objektin e veprimtarisë në QKR, aktivitetin për të cilin ka ofertuar, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014.

5. B.H. me detyrë specialiste në drejtorinë ekonomike, në cilësinë e anëtarit të komisionit për llogaritjen e fondit limit dhe KVO, për arsye se:

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “**Blerje shtypshkrime viti 2014**” me fond limit 13,811 mijë lekë, ka rillogaritur fondin limit, duke ndryshuar fondin e llogaritur nga komisioni i

specifikimeve teknike dhe llogaritjes së fondit limit i caktuar nga titullari i autoritetit Kontraktor në shumën 4,104,440 lekë, duke shkaktuar *efekt ekonomik negativ për institucionin në shumën 1,658,880 lekë, me tvsh*. Specialistja e programimit është njëherazi edhe anëtare e komisionit të vlerësimit të ofertave, në këtë rast ka tejkaluar kompetencat duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu V “Zhvillimi i procedurave” pika 2/c dhe me vetë urdhrin e titullarit të autoritetit Kontraktor.

6. B.S. me detyrë kryetare degës prodhimit lejeve, për arsye se:

-Në tenderin e zhvilluar me objekt *“Blerje targa prokat viti 2014”* me fond limit 49,255 mijë lekë, ka kualifikuar operatorin ekonomik , i cili ka paraqitur certifikatën e cilësisë ISO 9001; 2008 jashtë afateve, në kundërshtim me kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2. a dhe nenin 53 pika 3 të ligjit për prokurimin publik.

-Në tenderët e zhvilluar me objekt *“Blerje targa prokat viti 2014”* me fond limit 13,314 mijë lekë, *“Blerje prokat leje drejtimi dhe formularë aplikimi”*, me fond limit 61,590 mijë lekë, *“Blerje e pullave të taksës vjetore ”*, me fond limit 16,696 mijë lekë, nuk ka llogaritur dhe argumentuar fondet limit, sepse ka marrë të njëjtat oferta nga të njëjtët operatorë ekonomikë me të njëjtat çmime për të gjithë tenderët e zhvilluara për vitin 2014, duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu II pika 2/ç.

-Në tenderin me objekt *“Blerje prokat leje drejtimi”*, me fond limit 22,259 mijë lekë, ka kryer veprimet e marrjes në dorëzim të mallit pa certifikatën ISO të prodhuesit, duke mosplotësuar nenin 13 të kontratës *“Ekzaminimi dhe pranimi i mallrave”*.

7. B.L. me detyrë përgjegjës sektori i administrimit të rrjetit IT, në cilësinë e anëtarit të komisionit për llogaritjen e fondit limit, për arsye se:

-Në tenderët e zhvilluar me objekt *“Blerje targa prokat viti 2014”* me fond limit 13,314 mijë lekë, *“Blerje prokat leje drejtimi dhe formularë aplikimi”*, me fond limit 61,590 mijë lekë, *“Blerje e pullave të taksës vjetore”*, me fond limit 16,696 mijë lekë, nuk ka llogaritur dhe argumentuar fondet limit, sepse ka marrë të njëjtat oferta nga të njëjtët operatorë ekonomikë me të njëjtat çmime për të gjithë tenderët e zhvilluara për vitin 2014, duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu II pika 2/ç.

8. A.M. me detyrë specialiste për regjistrimin e mjeteve, në cilësinë e antarit të kvo, për arsye se:

-Në tenderin e zhvilluar me objekt *“Blerje targa prokat viti 2014”* me fond limit 49,255 mijë lekë, ka kualifikuar operatorin ekonomik , i cili ka paraqitur certifikatën e cilësisë ISO 9001; 2008 jashtë afateve, në kundërshtim me kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2. a dhe nenin 53 pika 3 të ligjit për prokurimin publik.

-Nuk ka hartuar drejt kriteret e veçanta të kualifikimit, kapacitetin teknik, etj kritere duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, neni 46 *“Kualifikimi i kandidatëve”* dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 Kreu III, pika 3/b.

9. I.G. me detyrë përgjegjës i sektorit të testimeve, në cilësinë e anëtarit të komisionit për llogaritjen e fondit limit dhe anëtarit të njësisë së prokurimit, për arsye se:

-Në tenderin e zhvilluar me objekt *“Blerje targa prokat viti 2014”* me fond limit 49,255 mijë lekë, nuk ka llogaritur e argumentuar fondin limit ka marrë ofertat më të larta dhe pa u bazuar në përvojën e mëparshme, për të arritur një kontratë me efektivitet dhe me vlerë më të ulët. Fondi limit është në shumën 15,647 mijë lekë më i lartë, nga përvoja e vitit të kaluar, duke sjellë efekt negativ për institucionin, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu II pika 2/ç.

-Ka zhvilluar tenderat me objekt *“Blerje autovetura për administratën për vitet 2014 dhe 2015”*, pa pasur në dispozicion kërkesat për nevojat e mjeteve, e cila është baza për

fillimin e një procedure prokurimi, në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

10. F.M. me detyrë drejtor i drejtorisë regjistrimin e mjeteve,

11. , me detyrë përgjegjës i sektorit të regjistrimit mjeteve, në cilësinë e anëtarëve të komisionit për llogaritjen e fondit limit, për arsye se:

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Blerje targa prokat viti 2014*” me fond limit 49,255 mijë lekë, nuk ka llogaritur e argumentuar fondin limit ka marrë ofertat më të larta dhe pa u bazuar në përvojën e mëparshme, për të arritur një kontratë me efektivitet dhe me vlerë më të ulët. Fondi limit është në shumën 15,647 mijë lekë më i lartë, nga përvoja e vitit të kaluar, duke sjellë efekt negativ për institucionin, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu II pika 2/ç.

12. A.L. me detyrë drejtor i Drejtorisë Durrës, në cilësinë e anëtarit të komisionit për llogaritjen e fondit limit, për arsye se:

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Blerje prokat viti 2016*”, me fond limit 30,780 mijë lekë, ka shpallur fitues operatorin ekonomik “■■■■” i cili nuk ka të përfshirë në objektin e veprimtarisë në QKR, aktivitetin për të cilin ka ofertuar, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorin ekonomik pa plotësuar kriteret e kualifikimit, në lidhje me afatin e lëvrimin, në kundërshtim me dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga autoriteti kontraktor.

13. H.K. me detyrë kryetar i degës së financës DTSH, Durrës, në cilësinë e anëtarit të KVO,

14. K.B. me detyrë arshivistë, në cilësinë e anëtarit të KVO, për arsye se:

-Në tenderin me objekt “*Blerje prokat leje drejtimi*”, me fond limit 22,259 mijë lekë, ka kryer veprimet e marrjes në dorëzim të mallit pa certifikatën ISO të prodhuesit, duke mos plotësuar nenin 13 të kontratës “Ekzaminimi dhe pranimi i mallrave”.

15. R.Q. me detyrë specialiste në sektorin e kualifikimeve, në cilësinë e anëtarit të KVO

16. L.L. me detyrë specialiste në sektorin e administrimit dhe mirëmbajtjes, në cilësinë e anëtarit të KVO, për arsye se:

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Mirëmbajtja e sistemit të lejeve të drejtimit*”, me fond limit 5,194 mijë lekë, ka shpallur fitues operatorin ekonomik “■■■■” i cili nuk ka të përfshirë në objektin e veprimtarisë në QKR, aktivitetin për të cilin ka ofertuar, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014.

17. V.C. me detyrë përgjegjëse sektori e licencimit dhe certifikimit, në cilësinë e anëtarit të komisionit për llogaritjen e fondit limit

18. A.M. me detyrë specialiste në sektorin e planifikimit, në cilësinë e anëtarit të komisionit për llogaritjen e fondit limit, për arsye se:

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Blerje e pullave të taksës vjetore*”, me fond limit 16,696 mijë lekë, nuk ka llogaritur dhe argumentuar fondin limit, sepse ka marrë të njëjtat oferta nga të njëjtët operatorë ekonomikë me të njëjtat çmime për të gjithë tenderët e zhvilluara për vitin 2014, duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu II pika 2/ç.

Llogaritja e fondit limit është bërë me çmim më të lartë/njësi në shumën 1,912 mijë lekë, nga përvoja e vitit të kaluar. Po kështu, operatori ekonomik fitues “■■■■”, ka ofertuar dhe

nënshkruar kontratën 68% më të ulët se ofertat të cilave ju është referuar komisioni për llogaritjen e fondit limit.

Shënim: Për z. A.N., në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për llogaritjen e fondit limit, për mangësitë e konstatuara në tenderët me objekt “Blerje prokat leje drejtimi” me fond limit 13,314 mijë lekë dhe “Blerje prokat leje drejtimi dhe formularë aplikimi” me fond limit 61,590 mijë lekë, nuk rekomandojmë masë disiplinore, sepse është larguar nga puna.

Ky auditim është vlerësuar dobët nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R